

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-153/13

Prishtinë,
26 Mars 2014

Në çështjen juridike të:

F. A.

K.

E përfaqësuar me autorizim nga:

Sh. Xh.

Rruga M. Sh.

G.

Pala ankuese

kundër.

S. TH.

M.T. 2.

K.

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët: Willem Brouwer, Kryetar i Kolegjit, Esma Erterzi dhe Sylejman Nuredini, Anëtarë, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/167/2012, të datës 5 shtator 2012 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA1340, në tekstin e mëtejme si vendimi i KKPK-së), pas shqyrtimit të mbajtur me 26 mars 2014, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e ushtruar nga F. A. kundër vendimit të Komisionit KPCC/D/R/167/2012 i datës 5 shtator 2012, pasi që lënda ishte vendosur paraprakisht me vendim të plotfuqishëm administrativ apo gjyqësor (*res judicata*);
2. Konfirmohet vendimi i KKPK-së, KPCC/D/R/167/2012, i datës 5 shtator 2012, për sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA 1340.

Përmbledhja e çështjeve procedurale:

1. Më 3 dhjetor 2007, F. R. A., i përfaqësuar nga bashkëshortja e tij F. A., ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), duke kërkuar konfirmimin e së drejtës së saj për shfrytëzimin e një banese me sipërfaqe prej 26.20 m² në rrugën Marshal Tito nr. 21 në Kamenicë (në tekstin e mëtejshëm: banesa).
2. KKPK-ja kishte vendosur që të hedhë poshtë kërkesën për shkak se ishte *res judicata*.
3. Vendimi i KKPK-së i ishte dorëzuar Sh. Xh.më 10 korrik 2013, i cili ka paraqitur në emër të paraqitësit të kërkesës ankese në AKP kundër vendimit të KKPK-së më 1 gusht 2013, që është brenda afatit prej 30 ditëve të përcaktuar me nenin 12. 1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 (tani e tutje: Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50) për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronë e paluajtshme private, duke përfshirë edhe pronën bujqësore dhe atë komerciale.
4. Më 24 tetor 2013, S. Th. duke qenë se e kishte zënë banesën, ishte njoftuar për ankesën si palë e interesuar. Ajo ka paraqitur përgjigje më 30 tetor 2013.

Përmbledhja e çështjeve faktike

5. Më 12 janar 2000, pala ankuese ka paraqitur kërkesë në Drejtoratin për Çështje Pronësore dhe Banesore.
6. Kjo kërkesë kishte të bënte me të njëjtën banesë dhe ndaj të njëjtës është dhënë përgjigje.
7. Në vendimin e vet të vërtetuar të datës 18 qershor 2005, nr. HPCC/195/2005//A&C, Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore (KKPB) e ka refuzuar kërkesën.

Arsyetim ligjor:*Qëndrimi i palëve*

8. Pala ankuese kërkon që vendimi i KKPK-së lidhur me lëndën KPA 1340 të priset dhe lënda të kthehet në KKPK me qëllim që të vlerësohet e drejta e shfrytëzimit të banesës nga pala ankuese dhe në këtë mënyrë atij t'i kthehet e drejta e shfrytëzimit.
9. Pala ankuese pretendon se vendimi i KKPK-së është marrë në shkelje të nenit 182, paragrafit 1 në lidhje me nenin 70 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (Ligji nr. 03/L-006, në tekstin e mëtejshëm si *LPK*). Kjo për faktin se KKPK-ja, gjatë vlerësimit të kërkesës së palës ankuese, nuk ka verifikuar *ex officio* nëse S. Th. ka mundur të jetë palë në procedurë.
10. Pala ankuese më tej deklaron se neni 182, paragrafi 2, nën-paragrafi n i LPK-së janë shkelur pasi që (thënë shkurt): vendimi i KKPK-së përmban shumë gabime dhe dispozitivi i tij është i pakuptueshëm dhe kundërthënës në vetvete.
11. Pala ankuese më tej deklaron se është shkelur neni 183 i LPK-së, sepse organi i shkallës së parë ka bërë vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike.

Juridiksioni

12. Gjykata Supreme ka juridiksion.

Pranueshmëria

13. Ankesa është e pranueshme.

Meritat

14. KKPK-ja e ka hedhur poshtë kërkesën në bazë të nenit 11.4.c të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, pasi që kërkesa ishte vendosur paraprakisht me vendim të plote fuqishëm administrative apo gjyqësor (*res judicata*).
15. Siç përmendet më lartë në paragrafët 5, 6 dhe 7, çështja ishte vendosur nga KKPB-ja, ky vendimi i datës 18 qershor 2008 është bërë i plotfuqishëm, prandaj KKPK-ja ka marrë vendim të drejtë dhe të bazuar në argumente të drejta.
16. Gjykata Supreme nuk merret me pretendimet e palës ankuese të përmendura në paragrafin 10. Vendimi i KKPK-së është arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme nga KKPK-ja në paragrafët 50 dhe 51 të vendimit të KKPK-së. Konkludimi përfundimtar i vendimit të KKPK-së: "*hidhet poshtë kërkesa*", është formuluar qartë si në dispozitiv ashtu edhe paragrafin e 51 të vendimit të KKPK-së dhe në paragrafin 1 të vendimit të vërtetuar. Gjykata Supreme nuk ka vërejtur gabime esenciale.

17. Sa i përket shkeljes së nenit 70 të LPK-së (pretendimi në paragrafin 9), Gjykata Supreme konsideron se mbështetja në nenin 70 të LPK-së është gabim, pasi që ky nen ka të bëjë përjashtimin e gjyqtarëve. Sidoqoftë, teksti i ankesë thekson: “...Komisioni fillimisht është dashur të verifikojë nëse personi është paraqitur si palë në procedurë në përputhje me nenin 70 të LPK-së, për të cilën Komisioni është dashur të kujdeset sipas detyrës zyrtare”. Në këtë mënyrë i referohet tekstit të nenit 76 të LPK-së: “Gjatë tërë procedurës gjykata duhet të kujdeset, sipas detyrës zyrtare, nëse personi që paraqitet si palë mund të jetë palë në procedurë (...)”.
18. Çfarëdo që të mund të jetë ky pretendim, kjo nuk e ndryshon vendimin. KKPK-ja mundësi që të vendoste për këtë lëndës, gjë që edhe e ka bërë, pasi që kompetenca e palëve të përfshira nuk ka mundur të ndryshonte në asnjë mënyrë faktin se çështja tashmë ishte vendosur nga KKPB-ja.
19. Sa i përket pretendimit të përmendur në paragrafin 11: faktet lidhur me meritat e lëndës janë vërtetuar nga KKPB-ja me vendimin e 18 qershorit 2005, nr. HPCC/195/2005/A&C. Ky vendim është i plotfuqishëm dhe nuk do të rishqyrtohet nga Gjykata Supreme.
20. Nëse pala ankuese e konsideron KKPB-në si shkallë të parë, ky pretendim nuk qëndron. KKPK-kishte mundësi që të vendoste për këtë lëndës, gjë që edhe e ka bërë, pasi që (ri)-vërtetimi i fakteve nuk ka mundur të ndryshonte në asnjë mënyrë faktin se çështja tashmë ishte vendosur nga KKPB-ja.

Konkludim

21. Rrjedhimisht mbi të më sipërmen e me aplikim të nenit 13.3 (c) i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore

22. Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Willem Brouwer, Kryetar i Kolegjit, EULEX

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Esma Erterzi, Gjyqtar i EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it